



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Në bazë të nenit **11.pika 3.gj.** të Statutit të Kolegjit “BIZNESI” në Prishtinë, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor, më 27. 01. 2012 miratoi këtë

RREGULLORE

PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES NË THIRRJE MËSIMORE SHKENCORE, THIRRJE MËSIMORE, MËSIMORE-PROFESIONALE DHE THIRRJE BASHKËPUNËTORI

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret unike dhe procedurat për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrje bashkëpunëtori në Kolegjin “BIZNESI”.

Aktiviteti mësimor dhe kërkimor-shkencor në departamente bëhet nga persona të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrje bashkëpunëtori në Kolegjin “Biznesi”.

Aktivitet të arsimit superior mund të bëjë personi i zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, përkatësisht thirrje mësimore, për kohën për të cilën është zgjedhur.

1. Titujt

1.1.Në Kolegjin “BIZNESI” tituj mësimor-shkencor janë: Profesor , Profesor i Asocuar dhe Profesor Asistent.

Ndërsa në cilësinë e titujve të bashkëpunëtorëve janë: Asistent i ri, Asistent, Ligjërues,

1.2 Kolegji Biznesi bazuar në Ligjin per Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës- **Ligjin nr.04-L-037** per avancimin e personelit dhe gradimin me tituj bënë dhenien e titujve dhe gradave te personelit akademik duke percaktuar kriteret sipas kësaj rregullore.

2. Kriteret për zgjedhjen në tituj

Elementet të cilat mund të merren parasysh për zgjedhjen në titull **Profesor asistent**, përveç elementeve të parapara me ligj dhe mbi bazë të së cilës vërtetohen notat e përgjithshme të referatit të komisionit recensues janë:

- grada shkencore doktor i shkencave të fushës përkatëse shkencore nga e cila zgjedhet;

- të ketë së paku 3 (tri) punime shkencore të publikuara në revista shkencore;

- aftësitë e treguara për punë kualitative në procesin edukativo–arsimor;

- dispensë interne të ushtrimeve ose praktikës, e lejuar nga KLMSH, ose së paku 3 punime profesionale (shkencore të mirënjohura);

- pjesëmarrje në projekte shkencore;

- pjesëmarrje në punë të shoqatave profesionale ose forma tjera të punës edukativo-shkencore në Kolegjin “BIZNESI”.

Në punimet shkencore, kandidati duhet të jetë autor udhëheqës (kryesues), ndërsa ato duhet të jenë të botuara ose të paraqitura në mënyrë të tillë që profesioni (drejtimi) t'iu pranojë njohuri ndërkombëtare, të kenë njohuri të kulturës nacionale ose shtetërore.

Elementet të cilët duhet të merren parasysh për zgjedhjen në thirrjen **Profesor Kolegji**, përveç elementeve të përcaktuar në Ligj dhe në bazë të të cilëve përcaktohet notimi total i referatit të komisionit recensues, janë:

- gradë shkencore doktor i shkencave nga lëmi shkencor nga i cila zgjedhet,
- publikim i së paku 7 punimeve shkencore gjatë zgjedhjes së parë në atë thirrje, përkatësisht 3 në mes dy zgjedhjeve, prej të cilëve në 1 duhet të jetë autor i parë, përkatësisht prezantime publike të punimeve në formë të pranuar në profesion, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në lëmin në të cilin zgjedhet;
- aftësi për realizim cilësor të punës mësimore edukativo-arsimore;
- pjesëmarrje me referate në tubime shkencore ndërkombëtare;
- pjesëmarrje në qendra ndërkombëtare shkencore;
- udhëheqës në projekte shkencore;
- mentor për punime të magjistraturës dhe doktoratës;
- publikim i librave apo mjeteve ndihmëse;
- pjesëmarrje në punën e shoqatave shkencore ose profesionale në kuadër të fakultetit dhe jashtë vendit;
- ndikim në zhvillimin e mendimit shkencor dhe aftësim praktik në lëmin përkatës;
- kontribut në krijimin dhe aftësimin e bashkëpunëtorëve dhe ligjëruesve të ri dhe aftësimin e tyre për punën edukativo-arsimore;

3. Kriteret për zgjedhjen në thirrje profesionale- shkencore

Si **lektor (ligjërues)** mund të zgjedhet personi, i cili ka kryer studime pasdiplomike në lëmin shkencor në të cilin zgjidhet dhe tregon aftësi për punë mësimore, aftësi të lartë profesionale, si dhe personi i cili ka kryer arsimim të lartë përkatës, zotëron problemet e disiplinës së vet dhe ka përvojë në mësimin praktik.

4. Kriteret për zgjedhje në titull: Asistent i ri, Asistent dhe Ligjërues

Si **asistent i ri** mund të zgjedhet personi i cili ka të kryer arsimim të lartë përkatës me notë mesatare së paku 8.00 dhe ka regjistruar studimet e postdiplomës në drejtimin përkatës, ka moshën nën 25 vjeçare, zotëron një nga gjuhët botërore dhe tregon aftësi për punë mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe tregon interes të posaçëm për lëmin, përkatësisht lëndën për të cilën zgjedhet.

Si **asistent** mund të zgjedhet personi i cili ka të kryer studime pasdiplomike, master në lëmin shkencor përkatës, zotëron një nga gjuhët botërore dhe tregon aftësi për aktivitet mësimor shkencor.

Si **ligjërues** mund të zgjedhet personi i cili ka kryer studime pasdiplomike dhe ka master në lëmin shkencor në të cilin zgjidhet dhe tregon aftësi për punë mësimore, aftësi të lartë profesionale, ose i cili ka kryer arsimim të lartë përkatës, zotëron problemet e disiplinës së vet dhe ka përvojë të veçantë në mësimin praktik.

Zgjedhja në thirrje mësimore-shkencore bëhet në mënyrë periodike.

5. Afatet për të cilët bëhet zgjedhja

Profesor Asistent ,Profesori i Asocuar dhe Profesori zgjidhen në afat prej 3-5 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

Asistenti i ri zgjidhet ne afat prej 3 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

Asistenti zgjidhet në afat prej 3-5 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një afat.

Ligjëruesi zgjedhet në afat prej 3 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Procedura e zgjedhjes

6.1. Konkurs –shpallja publike për zgjedhje

Vendim për hapjen e procedurës për zgjedhje në thirrje, në rast se zgjedhja bëhet për herë të parë, sjell Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit “Biznesi”.

Vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhje të personave të zgjedhur sjell Dekani gjashtë muaj para kalimit të kohës në të cilën janë zgjedhur.

Konkursin për zgjedhje e shpall dekani.

Zgjedhja në thirrje mësimore-shkencore, thirrje mësimore dhe bashkëpunëtorë bëhet nëpërmjet konkursit publik të shpallur në mjetet e informimit dhe ne web-faqen e Kolegjit“Biznesi”.

Konkursi zgjat 15 ditë nga dita e shpalljes.

Konkursi duhet të përmbajë lëmin që i takon veprimtarisë përkatëse mësimore shkencore, për të cilin zgjedhet kandidati, afatin, si dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje.

Procedura për konkursin për zgjedhje mësimore shkencore, mësimore, mësimore profesionale dhe thirrje bashkëpunëtorë në Kolegj zgjat 3 muaj. Një ditë pas përfundimit të konkursit fillon procedura e lartpërmendur.

7. Zgjedhje e parakohshme në thirrje më të lartë

Kandidati në thirrje mësimore-shkencore, thirrje mësimore dhe thirrje bashkëpunëtorë mund të zgjidhet në thirrje më të lartë në lëmin e njëjtë mësimore-shkencore edhe para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur, nëse i plotëson kushtet për zgjedhje të parapara me këtë rregullore: nëse ka kaluar së paku gjysmën e kohës në thirrjen që ka, tregon sukses të veçantë në procesin mësimor, punën shkencore në lëmin gjegjës, respektivisht në punën profesionale akademike dhe nëse ka kontribuar veçanërisht në aplikimin dhe zbatimin e veprimtarisë shkencore në lëmin për të cilin është zgjedhur.

Iniciativë për avancim të parakohshëm të kandidatit marrin së paku dy Programe të kolegjit nga veprimtaria e njëjtë mësimore shkencore për ku bëhet zgjedhja, me propozim të arsyetuar me shkrim, ku veçanërisht potencohen rezultatet e mira të kandidatit.

Nëse në kuadër të kolegjit nuk ka njësi organizative nga ajo veprimtari mësimore shkencore, iniciativën për avancim të parakohshëm mund ta marrë njësi organizative nga organizata tjetër e arsimit të lartë në kuadër të Kolegjit “Biznesi”.

Pas iniciativës së arsyetuar për nisjen e procedurës për avancim të parakohshëm do të vendosë Këshilli i Kolegjit.

Zgjedhjen e kandidatit në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore profesionale dhe thirrje në bashkëpunëtorë e bën Këshilli i Kolegjit, në bazë të vlerësimit të referatit të komisionit për recensión.

8. Komisioni recensues

8.1. Komisionin recensues e formon Këshilli i Kolegjit në afat jo më vonë se 5-10 ditë nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e kërkesës së kandidatit.

Dekani në afat prej jo më vonë se 8 ditëve i lajmëron anëtarët e Komisionit recensues për formimin dhe përbërjen e komisionit recensues.

Komisioni recensues përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë nga Programi ku bëhet zgjedhja dhe nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit.

Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë në thirrje më të ulët se thirrja për të cilën konkurron dhe zgjedhet kandidati.

Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë edhe persona të pensionuar me thirrje mësimore shkencore, thirrje në profesor të rregullt të cilët i plotësojnë kushtet nga kjo Rregullore.

Më shumë se gjysmën e anëtarëve të komisionit recensues e përbëjnë personat në thirrje mësimore shkencore dhe mësimdhënës të po të njëjtës lëmi, ndërsa anëtarët tjerë mund të jenë të drejttimeve të përafërta mësimore shkencore.

Afërsinë e përcakton Këshilli i Kolegjit “Biznesi”, në bazë të veprimtarisë shkencore dhe disiplinave të përcaktuara nga Kolegji.

Komisioni recensues ofron referat për të gjithë kandidatët e paraqitur dhe propozon njërin nga kandidatët që i plotëson kushtet për zgjedhje në thirrje dhe i propozon thirrjet në të cilën mund të zgjedhet. Komisioni recensues është i obliguar të dorëzojë referat në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimeve për zgjedhjen e anëtarëve të vet dhe të dokumentacionit.

Nëse komisioni recensues nuk dorëzon referat në afatin e caktuar, formohet komision i ri recensues. Propozimin e ri për formimin e komisionit recensues e ofron dekani.

Komisioni recensues propozimin për zgjedhje të kandidatit e aprovon nga shumica e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Nëse komisioni recensues nuk ka propozim, formohet komision i ri recensues.

8.2. Referatet e komisionit recensues përmbajnë: të dhëna biografike të kandidatit, vlerësimin e të arriturave shkencore, profesionale, pedagogjike dhe të arritura tjera të kandidatit të cilat janë me rëndësi për përcaktimin e kushteve për zgjedhje në thirrje, të dhëna për shpalljen e punimeve shkencore dhe profesionale nga vlerësimet e atyre punimeve si dhe propozim për zgjedhjen e kandidatit në thirrje të caktuar.

Referati, respektivisht raporti shpallet në gjuhën shqipe.

Nëse ekzistojnë mendime të ndara të anëtarëve të komisionit recensues nga propozimi për zgjedhje të kandidatit, mendimet së bashku me referatet shpallen në buletin e Kolegjit.

Nëse në konkurs paraqiten candidate të cilët nuk i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje adekuate, komisioni recensues konstaton mosplotësimin e kushteve dhe për këtë e njofton Këshillin e Kolegjit

Në afat prej 5 ditësh nga dita e publikimit të referatit nga Komisioni recensues në buletin e Kolegjit personat e interesuar (pjesëmarrës në procedure, punëtorë mësimore-shkencor, mësimdhënës dhe bashkëpunëtor nga departamentet dhe nga lëmit përkatëse mësimore shkencore të institucioneve të arsimit të lartë) mund të dorëzojnë kundërshtim referateve të shpallura për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore, mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori.

Kundërshtimi i dorëzohet komisionit recensues nëpërmjet Dekanit. Komisioni recensues jep përgjigje ndaj kundërshtimit në afat prej 5 ditësh.

9. Vendosja për zgjedhje

Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit "Biznesi" procedon dhe voton zgjedhjen e kandidatëve për thirrje mësimore-shkencore nëse janë prezentë dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit me të drejtë vote.

Punonjësi mësimor shkencor i kolegjit zgjidhet nëse fiton shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit të Kolegjit me të drejtë vote.

Këshilli i Kolegjit bën zgjedhjen në thirrje të bashkëpunëtorit, nëse në mbledhje janë prezent dy të tretat nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të lartë shkencor-mësimor të Kolegjit me të drejtë vote.

Nëse gjatë zgjedhjes punonjësi mësimor-shkencor dhe bashkëpunëtori për thirrje më të lartë nuk e fiton shumicën e duhur të votave, atëherë i njëjti mbetet në thirrjen që ka.

10. Përsonat që nuk janë zgjedhur

Kandidati që nuk zgjedhet, ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e njoftimit për moszgjedhje. Ankesa i drejtohet Komisionit të formuar nga Këshilli i Kolegjit.

Komisioni i formuar nga Këshilli, në afat prej 30 ditëve nga pranimi i ankesës së kandidatit, formon komision tre anëtarësh me tituj profesorë ordinare, nga të cilët, dy do të jenë nga lëmi i njëjtë ose i përafërt mësimore shkencore.

Komisioni në afat prej 30 ditësh, dorëzon raport deri te Këshilli me vlerësim për zgjedhjen dhe arsyetimin e zgjedhjes.

Komisioni mund të propozojë që kandidati të zgjedhet në thirrje ku më parë ka qenë i zgjedhur, të propozojë të zgjedhet në thirrje për të cilën ka konkurruar kandidati ose të propozojë që të përkrahet vendimi i Këshillit të Kolegjit .

Vendimi i Komisionit është përfundimtar

11. Ndërprerje e parakohshme e zgjedhjes

Kandidatit të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës edhe para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur, në kushte dhe procedurë të përcaktuar me Statutin e Kolegjit.

Iniciativë për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes merr dekani i kolegjit, organi i njësisë së brendshme organizative, ose së paku 5 punonjës shkencor-mësimor .

Këtë iniciativë e shqyrton Këshilli i Kolegjit.

Nëse Këshilli i Kolegjit e pranon iniciativën, formon komision të përbërë nga tre profesorë të rregullt, ku dy janë nga drejtimi përkatës mësimor-shkencor ku është zgjedhur kandidati, me detyrë të përgatisë raport në bazë të të cilit do të përgatitet vendim për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes.

Vendimi i Komisionit për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes publikohet në buletin e Kolegjit.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje për procedurën për zgjedhje në thirrje në mënyrë adekuate zbatohen edhe për procedurën për ndërprerje të parakohshme të zgjedhjes.

12. Pjesëmarrje të shkencëtarëve të afirmuar, profesionistë nga praktika

Me qëllim të prezantimit të të arriturave, shkencëtarë të afirmuar, profesionistë të dalluar nga ekonomia dhe juridiku, menaxhimi i emergjencave dhe menaxhimi i politikave të sigurisë mund të marrin pjesë në kryerjen e detyrave të caktuara nga disiplinat mësimore-shkencore, në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Statutin e Kolegjit .

13. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së miratimit kurse iniciativën për ndryshimet e Rregullores mund t'i paraqesë 1/3 e anëtarëve të Bordit, dekanit dhe Këshillit të Kolegjit.

14. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan